



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Regj.
2020

Ballsh, më ____ . ____ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK – TIRANË (SPE)

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën www.app.gov.al

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 29.01.2020

Për: **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B & “MCE” shpk, me NIPT L72203065K, me adresë Rruga “Mustafa Matohiti”, banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe (adresa e përfaqësuesit të BOE).**

* * *

Procedura e prokurimit: **“E hapur” (me lote)**

Numri i references së Lotit 7: **REF-44417-11-21-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti 7: Hartim projekti “Rikonstruksion i rrugës nga Rr.Nacionale Levan-Tepelenë - Ninësh – Gadurovë”**, me fond limit **1.238.550** (një milion e dyqind e tridhjetë e tetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**, me afat 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.47, datë 25 nëntor 2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik **“6D-PLAN” shpk, me NIPT L62717405H**, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën **1,238,500** (një milion e dyqind e tridhjetë e tetëmijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**.

2. Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk, me NIPT K72113010E, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 997,035 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “C.E.C GROUP” shpk, me NIPT L11807013M, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 1,072,950 (një milion e shtatëdhjetë e dymijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik “ERALD-G” shpk, me NIPT K36306784K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 1,091,163 (një milion e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.
5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B & “MCE” shpk, me NIPT L72203065K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 1,069,500 (një milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.
6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “NOVATECH STUDIO” shpk, me NIPT L01717030C & “KLODIODA” shpk, me NIPT K51813002H, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 1,042,562.6 (një milion e dyzetë e dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë gjashtë) lekë pa TVSH.
7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “SELAS” shpk, me NIPT J71826005F & “LENI-ING” shpk, me NIPT J88730334W, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 1,070,103 (një milion e shtatëdhjetë mijë e njëqind e tre) lekë pa TVSH.
8. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “SPHAERA” shpk, me NIPT J81809003U & “KLODIODA” shpk, me NIPT K51813002H, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Operatori Ekonomik “6D-PLAN” shpk, me NIPT L62717405H, për arsye se nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:**

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.4. “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të DST (Kërkesë e riformuluar sipas Shtojcës së ngarkuar në sistemin e prokurimit publik datë 12.12.2019), pasi duke qenë se është ofertuar në të 11 Lotet e procedurës, rezulton se vlera e shërbimeve të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, është më e vogël se shumatorja e vlerave të përcaktuara për lotet ku është ofertuar. Kjo pasi, për disa nga kontratat e lidhura me institucione publike, nuk është paraqitur vërtetimi i lëshuar nga enti publik për realizimin e kontratës, konkretisht: - nuk është paraqitur vërtetimi për realizimin e kontratës së lidhur me Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, me nr.694 prot, datë 19.07.2016; - nuk është paraqitur vërtetimi për realizimin e kontratës së lidhur me Entin Kombëtar të Banesave, me nr.1929/2 prot, datë 30.08.2016; - nuk është paraqitur vërtetimi për realizimin e kontratës së lidhur me Bashkinë Vlorë, me nr.1131 prot, datë 09.02.2018; nuk është paraqitur vërtetimi për realizimin e kontratës së lidhur me Albafilm Sh.A, me nr.prot.184, datë 02.09.2016; nuk është paraqitur vërtetimi për realizimin e kontratës së lidhur me Autoritetin Portual Durrës, me nr.2258/3 prot, datë 04.06.2018; nuk është paraqitur vërtetimi për realizimin e kontratës së lidhur me Kryeministrinë, me nr.5871/2 prot, datë 15.11.2017; nuk është paraqitur vërtetimi për realizimin e kontratës së lidhur me Akademinë e Sigurisë, me nr.54/3 prot, datë

20.07.2018.

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2.4. “Kapaciteti teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të DST (Kërkesë e riformuluar sipas Shtojcës së ngarkuar në sistemin e prokurimit publik datë 12.12.2019), pasi për drejtuesin teknik të shoqërisë, Inxhinierin Hidroteknik Alfred Nikolli, nuk është paraqitur licenca profesionale në projektim.

2. Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk, me NIPT K72113010E, për arsye se nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “g”, të pikës 2.4. “Kapaciteti teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të DST, pasi vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga ofertuesi është nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “NOVATECH STUDIO” shpk, me NIPT L01717030C & “KLODIODA” shpk, me NIPT K51813002H, për arsye se është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në dokumentat e tenderit dhe ato të bëra në VKM nr.914, datë 29.12.2018 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi:

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, është konstatuar se shoqëria “Klodioda” shpk ka paraqitur ofertë ekonomike edhe si pjesë e një bashkimi tjetër operatorësh ekonomikë.

Konkretisht, kjo shoqëri ka ofertuar edhe si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë JV “Sphaera” shpk & Klodioda” shpk, zyrtarizuar sipas Kontratës Noteriale të Bashkëpunimit nr.10455 rep, nr.2681 kol, datë 20.12.2019 dhe nëpërmjet Prokurës së Posaçme nr.10456 rep, nr.2682 kol, datë 20.12.2019, shoqëria “Sphaera” shpk është autorizuar nga shoqëria “Klodioda” shpk si përfaqësuese e këtij bashkimi.

Në këto kushte, oferta e paraqitur nga BOE “Novatech Studio” shpk & “Klodioda” shpk, është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 63, pika 2, paragrafi 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2018 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Dokumentat Standarte të Tenderit, Kreu II “Udhëzime për Oeratorët Ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.6, ku citohet: “Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë”.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “SELAS” shpk, me NIPT J71826005F & “LENI-ING” shpk, me NIPT J88730334W, për arsye se nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 2.3. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të DST, pasi nga shoqëria “Selas” shpk nuk është paraqitur Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2018, lëshuar prej njësisë së vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetin, referuar adresës/ave kryesore dhe dytësore sipas ekstraktit të QKB.

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2.4. “Kapaciteti teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të DST, pasi asnjë nga kontratat e shërbimeve të mëparshme të paraqitura nuk është e vlefshme. Shoqëria “Leni-Ing” shpk nuk

ka paraqitur asnjë kontratë shërbimi në projektim, por ka paraqitur vetëm një kontratë për mbikqyrje punimesh si bashkim operatorësh me “Selas” shpk, lidhur me Bashkinë Berat më datë 01.06.2015, e cila përveçse nuk konsiderohet shërbim i ngjashëm, është edhe përtej afatit të kërkuar. Ndërsa të gjitha vërtetimet e kontratat e shërbimeve të mëparshme të paraqitura nga shoqëria “Selas” shpk nuk merren në konsideratë, pasi: - Për kontratën e lidhur me Bordin Rajonal të Kullimit Fier datë 14.11.2016, nuk është paraqitur vërtetimi i realizimit të kësaj kontrate, pasi vërtetimi bashkëlidhur saj bën fjalë për një tjetër kontratë me nr.458/9 prot, datë 26.11.2015; - Kontrata e lidhur me QTTB Fushë-Krujë me nr.234 prot, datë 21.07.2015, është realizuar përtej afatit të kërkuar; - Kontrata e lidhur me QTTB Fushë-Krujë me nr.161 prot, datë 24.06.2015, është realizuar përtej afatit të kërkuar, si dhe nuk është paraqitur raporti (%) i pjesëmarrjes në bashkim me operatorin “Elba” shpk; - Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Roskovec me nr.7532 prot, datë 27.12.2019, nuk merret në konsideratë, pasi nuk është shoqëruar me kontratat respektive; - Për kontratën e lidhur me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Fier nr.569/22, datë 23.11.2017, nuk është paraqitur raporti (%) i pjesëmarrjes në bashkim me operatorin “Vlash Dhamo”; - Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Roskovec me nr.2186 prot, datë 18.05.2018, nuk merret në konsideratë, pasi nuk është shoqëruar me kontratat respektive; - Kontrata e lidhur me Bashkinë Divjakë nr.995/1 prot, datë 01.04.2015, është kontratë për mbikqyrje punimesh, e cila përveçse nuk konsiderohet shërbim i ngjashëm, është edhe jashtë afatit.

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2.4. “Kapaciteti teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të DST, pasi shërbimet që lidhen me profesionin e inxhinierit gjeodet janë marrë përsipër të kryhen nga shoqëria “Selas” shpk, dhe për drejtuesen teknike të kësaj shoqërie, ing.gjeodet L. Bano nuk është paraqitur diploma, cv dhe kontrata e punës.

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “f”, të pikës 2.4. “Kapaciteti teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të DST, pasi shoqëria “Selas” shpk nuk ka paraqitur certifikimin ISO 39001:2012. Gjithashtu, edhe certifikatat ISO të paraqitura nga shoqëria “Leni-Ing” shpk, nuk janë të vlefshme në aspektin formal, pasi nuk janë paraqitur në formën e kërkuar, origjinal ose kopje e noterizuar, por janë paraqitur fotokopje e thjeshtë.

5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “SPHAERA” shpk, me NIPT J81809003U & “KLODIODA” shpk, me NIPT K51813002H, është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në dokumentat e tenderit dhe ato të bëra në VKM nr.914, datë 29.12.2018 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi:

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, është konstatuar se shoqëria “Klodioda” shpk ka paraqitur ofertë ekonomike edhe si pjesë e një bashkimi tjetër operatorësh ekonomikë.

Konkretisht, kjo shoqëri ka ofertuar edhe si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Klodioda” shpk & “Novatech Studio” shpk, zyrtarizuar sipas Kontratës Noteriale të Bashkëpunimit (Për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë) nr.rep.8366, nr.kol.6697, datë 27.12.2019 dhe nëpërmjet Prokurës së Posaçme nr.rep.8366, nr.kol.6697, datë 27.12.2019, shoqëria “Novatech Studio” shpk është autorizuar nga shoqëria “Klodioda” shpk si përfaqësuese e këtij bashkimi.

Në këto kushte, oferta e paraqitur nga BOE “Sphaera shpk & Klodioda shpk”, është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 63, pika 2, paragrafi 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2018 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Dokumentat Standarte të Tenderit, Kreu II “Udhëzime për Oeratorët Ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.6, ku citohet: “Një Operator

Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B & “MCE” shpk, me NIPT L72203065K, me adresë Rruga “Mustafa Matohiti”, banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe (adresa e përfaqësuesit të BOE)**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1,069,500** (një milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.01.2020

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Qerim Ismailaj